

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BARAJ KONSTRUKSION” SHPK**

Sot, më 01.10.2024 unë, themeluesi,

- a) **Sulçe Baraj**, atësia Lefter, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BG5524924, me numër personal identifikimi I81219019O i datëlindjes 19.12.1988, lindur në Drenove, Fier dhe banues në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

kam krijuar këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1
Themelimi**

- Emri i shoqërisë është “**BARAJ KONSTRUKSION**” SHPK.
- Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitet ekonomik në fushën e ndërtimit, përfshirë ndërtimin e objekteve shumëkatëshe, rezidenciale, rrugësh, rikonstruksione, punime lyerje, punime hidraulike, elektrike, gipsi, suvatime etj. Gjithashtu, Shoqëria do të angazhohet në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Aktivitetet do të përfshijnë prodhimin dhe tregtimin e materialeve inerte për ndërtim. Shoqëria do të realizojë ndërtimin e sistemeve ujësjellës dhe kanalizimeve, përfshirë ndërtimin e impianteve vaditëse, punime për mbrojtjen e sistemeve hidraulike, ndërtimin e depove të ujësjellësit dhe ndërtimin e digave.

Po ashtu, Shoqëria do të ofrojë rikonstruksione dhe ristrukturime të ndërtesave civile dhe publike, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e dekorit në mjediset urbane, ndriçim dhe sinjalizim urban. Aktivitetet përfshijnë gjithashtu punime në sipërfaqe të gjelbëta, parqe dhe pyje, si dhe pastrim të sipërfaqeve urbane.

Ndërtime hidraulike dhe hidroteknike, përfshirë impiantet e sistemit të ujit dhe mirëmbajtjen e tyre, janë gjithashtu pjesë e shërbimeve që Shoqëria do të ofrojë. Shoqëria do të kryejë gjithashtu punime të specializuara në fushën e përforcimit të themeleve, izolim nëntokësor dhe mbi tokë nga ujërat, dhe puse shpime gjeologo-inxhinierike për ujë dhe struktura të tjera.

Në lidhje me energjinë, Shoqëria do të ofrojë projekte dhe zbatime për ndërtimin e impianteve energetike, përfshirë hidrocentrale, termocentrale, impiante volatake, ndërtimin e nënstacioneve dhe linjave të transmetimit, transformimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në rrjetet e tensionit të lartë, të mesëm dhe të ulët.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu çdo aktivitet tjeter ekonomik të lejuar nga legjislacioni shqiptar.



**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Brigada XI Sulmuese, 9301, Fier, Shqiperi
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar filletar i shoqërisë është 10,000.00 (dhjetë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (një) kuotë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a) Ortaku themelues Sulçe Baraj, zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10,000.00 (dhjetë mijë) Lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

**Neni 6
Administratori**

- 1) Administratori i shoqërisë emërohet Sulce Baraj, atësia Lefter, shtetas Shqiptar, identifikuar me anë të pasaportës me numër BG5524924, me numër personal identifikimi I81219019O, i datëlindjes 19.12.1988, lindur në Drenove, Fier dhe banues në Tirane, me afat emërimi 5 vite.

**Neni 7
Baza Ligjore**

- 1) Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 8
Mosmarrëveshjet**

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.



O R T A K U
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
BARAJ KONSTRUKSION SHPK

Sulce Baraj Baraj

(Emër, Mbiemër, Nënshkrimi)